



REPUBLIKA E KOSOVËS • REPUBLIKA KOSOVA • REPUBLIC OF KOSOVO

KOMUNA E FERIZAJT • OPŠTINA UROŠEVAC • MUNICIPALITY OF FERIZAJ



<http://kk.rks-gov.net/ferizaj>

Procesverbal

I Mbajtur në takimin e I-rë të Zgjedhjeve 2025, në mbledhjes inauguruese të Kuvendit të Komunës i mbajtur me datën 03.12.2025, në sallën e Kuvendit në ora 10⁰⁰ nën kryesimin e Kryesuesit Xhavit Zariqi si anëtar më i vjetër i kësaj legjislature, Xhavit Zariqi.

Fjalën Hyrëse – Kryesuesi të KK-së, Xhavit Zariqi;

I nderuar Kryetar i zgjedhur i Komunës së Ferizajt, z.Agim Aliu

Të nderuar anëtarë të zgjedhur të Kuvendit të Komunës së Ferizajt,

Të respektuara familje të dëshmorëve, Shoqata të Dalura nga Lufta e Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës, deputetë, ish kryetar të Komunës, përfaqësues të institucioneve shtetërore, shoqëri civile, bashkëqytetarë, zonja dhe zotërinj!

Në cilësinë e anëtarit më të vjetër të zgjedhur të Kuvendit të Komunës dhe kryesuesit të kësaj mbledhje, më lejoni t'ju uroj mirë se ardhje në mbledhjen inauguruese të Kuvendit të Komunës të ftuar nga Kryetari i zgjedhur i Komunës së Ferizajt.

Fillimisht më lejoni të konstatoj kuorumin për zhvillimin e kësaj mbledhje.

(nga Sekretariati i Kuvendit - konstatohet kuorumi i mbledhjes inauguruese)

Konstatoj se kemi kuorum dhe mund të vazhdojmë punimet e kësaj seance sipas rendit të ditës për këtë mbledhje inauguruese.

Sipas ftesës për këtë mbledhje inauguruese, të ftuar nga Kryetar i zgjedhur i Komunës, kemi këtë propozim për rend dite.

1.	Arritja dhe nënshkrimi i anëtarëve të Kuvendit të Komunës dhe pjesëmarrësve tjerë
2.	Fjala mirëseardhëse e anëtarit më të vjetër të Kuvendit të Komunës Fjala mirëseardhëse
3.	Kryesimi i mbledhjes nga anëtari më i vjetër i Kuvendit të Komunës - Dhënia e betimit nga anëtarët e Kuvendit të Komunës - Dhënia e betimit të Kryetarit të Komunës
4.	Fjala përshëndetëse e Kryetarit të Komunës
5.	Zgjedhja e Kryesuesit të Kuvendit të Komunës
6.	Mbyllja e seancës

Më pas kryesuesi ia kaloi fjalën Kryetarit të sapozgjedhur z.Agim Aliu.

Shumë të dashura familje të Dëshmorëve të Kombit e martirëve,

Invalidë e veteranë të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës, ish të burgosur politik,

I respektuar kryesuesi i mbledhjes inauguruese,
Të nderuar anëtarë të legjislaturës së re të Kuvendit të Komunës,
Deputetë, drejtues e përfaqësues të institucioneve të shtetit, klerit fetar,
Shoqëri civile, media, punonjës të administratës së Komunës,
Ferizajasit e mi të dashur,
Zonja dhe zotërinj!

Jam sot para jush, përballë secilit ferizajas, pranë të zgjedhurve të tyre, në këtë godinë muret e së cilës dëgjojnë prej dekadash zërin e çdo ferizajasi, i veshur me kostumin më të shndritshëm, më krenar – me privilegjin e pamat, nderin e jetës sime, besimin qëburoi nga ju e ju i dhatë emër dhe mbiemër, të jem sërish i zgjedhuri juaj, në krye të qytetit tonë, krenarisësonë, dashurisë sonë – FERIZAJT.

Janë pak javë që na ndanë nga koha kur folën ferizajasit. Ata folën me zë e gjuhë të qartë, folën me pastërtinë e shpirtit e kthjelltësinë e mendjes, me vlerësimin e të sotmes e sytë drejt së ardhmes – për Ferizajn e Gjeneratës Tjetër, për Ferizajn e shijes së gjithmonshme të suksesit.....

.....për qytetin që rritet, ecën me hapa gjigand- pa frikë drejt së ardhmes, për energjinë e zhvillimit qëkudo ndihet, për ta bërë të shndritshme çdo shkronjë të emrit të Ferizajt, për ta bërë krenarë çdo ferizajas kudo ku shkon e ngado ndodhet.

Përtej fjalive të gjata, zemra ime veç një fjalë flet: FALEMINDERIT E MIRËNJOHËS PËRJETË!

Unë gjithmonë e kam parë Ferizajn si shtëpinë e madhe që vë themele, ngre shtat e ndërtohet çdo ditë, me njerëz punëtorë, të zellshëm, të guximshëm e vizionar për të ardhmen.

Palëkundshëm, gjithë jetën time, kam besuar tek Ferizaj dhe potenciali që mban në shpirt dhe shpreh me vepra çdo ferizajas.

I kam besuar, mbështetur dhe i duartrokas veprat e ferizajasve që ka herë mbizotërojnë në gjeografinë kombëtare e lartësohen përtej saj.

Në sytë e mi, Ferizaj ishte gjithnjë përtej politikës, ferizajasit asnjëherë nuk i pashë me ngjyrat partiake ku përkisnin apo jepnin përkrahjen.

Ata ishin e janë të gjithë, familja jonë e madhe, qytetarë që i përkisnim të njëjtit qytet e fshat, ndanim të njëjtin fat, lidhnim pashkëputshëm të ardhmen bashkë.

Bashkë ecëm, të bashkuar ia dolëm, ta kemi sot, Ferizajn që krenarë e themi se nga jemi.

Qyteti që lindi me ekonomi, frymëzon me punë e jep shembull e shpresë me përkushtimin. Janë ferizajasit punëtorë, është shpirti ndërmarrës që i shquan - identitet krenar e motor që vë në lëvizje çdo ditë, hovet e reja të zhvillimit.

Mirënjohje e falënderim përjetësisht, arkitektëve të zhvillimit - bizneseve ferizajase!

Zonja dhe zotërinj!

Të dashur bashkëqytetarë!

Besimi juaj më 12 Tetor, regjistroi edhe një të veçantë historisë politike të Ferizajt. Është ky mandati i tretë pandërprerë qeverisës e më jetëgjati i të parit të Komunës së Ferizajt. Kjo më obligon edhe më shumë, kjo na vë mbi supë përgjegjësi edhe më të mëdha, për të qeverisur edhe më mirë, edhe më mirë, për të gjithë ju, çdo ditë, bashkë me ju.

Ne nuk jemi thjesht në garë me vitet, por me veprat qëndër vite shtrihen e i qëndrojnë palëkundshëm atyre, çmohen e i shërbejnë ferizajasve si dëshmi se vizioni nuk është thjesht fjalë goje, as dekor programatik politik, por Ferizaj në tjetër nivel, realitet i prekshëm, i përdorshëm, çdo ditë.

Ferizaj i sotëm nga ai i fund vitit 2017, është larg jo vetëm si vit kalendarik. E gjithmonë pranishmja dëshmitare është kujtesa e ferizajasve. Kudo shihet, ndihet në çdo hap. Energjia që rrjedh vrullshëm në kapilarë e i jep hov zhvillimit të Ferizajt.

Ne ndoqëm ëndrrën që ndër breza bëri gjumin, me guximin që merrte krahë e zemër tek secili ferizajas, gati për zgjimin që priste kaherë Ferizaj. Për ta këndellur, për ta ngritur në këmbë e për të zënëkarrigen që meriton, që i takon, në tryezën që mbledh sukseset.

Të dashur bashkëqytetarë!

Ju folët me besim, ne folëm me vepra e do të flasim përmes tyre. Ferizaj sot në trupin e tij vargon stoli të shumta. Janë ato që transformuan faqen e tij, janë ato që bëjnë dallimin tonë me të tjerët, janë ato që i shërbejnë si model të tjerëve, janë ato që gdhendën e i hapën perden horizonteve plot dritë të së ardhmes.

Mbi të gjitha janë ato vepra që flasin me zërin e qytetarëve, i kushtohen qytetarëve, i shërbejnë qytetarëve.

Ferizajn e presin vepra të reja. Është e pashtershme energjia jonë. Është i pandalshëm hapi ynë. Me ekipin tim, veçse kemi vënë kornizat e një dritareje të re të investimeve që sheh qartë perspektivën

e qytetit, zhvillimin e tij, për ta bërë edhe më të begatë, edhe më të pasur, edhe më krenarë, me punën tonë.

Bashkë me ju, anëtarë të legjislaturës së re të Kuvendit të Komunës, na presin pafund punë, nisma, ide e projekte për t'i përkthyer në dobi, lehtësi e mundësi për ferizajasit. Andaj përveç e përtej urimit për ju, ju ftoj tëjemi bashkë, për t'i dhënë atë çfarë meriton, pret, i takon Ferizajt.

Zonja dhe zotërinj!

Të nderuar anëtarë të Kuvendit të Komunës!

Autoritete mysafirë në këtë seancë inauguruese!

Ferizaj është mbi të gjithë dhe mbi të gjitha. Qyteti qëlindi me ekonomi, ngriti shtatin me udhën e hekurt qëgjarpëron në mes të zemrës së tij, ka një histori, ka njëkujtesë, ka një krenari që shumëfishohet e ngjit majat çdo ditë.

Çdo udhë rrëfen historinë e saj. Ky qytet u ngrit e mbijetoi me të panumërta sakrifica, me lavdinë qëshkroi kronikën krenare të historisë sonë, me guximin e grave e burrave syptrembur në betejat epike tëshekujve të shkuar, kryengritje gjithëpopullore, me luftën e lavdishme çlirimtare të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës, me heronjtë, dëshmorët e martirët – luftëtarët e lirisë – dalzotësit e atdheut– yje të përjetësisë së lirisësonë.

Gjithsecilit nga ne, historia i vë mbi supe, amanetet ndër breza. Ia kemi borxh së kaluarës krenare, ta ndërtojmë të tashmen më të mirë e të ardhmen dritëplote.

Secili nga ne mund ta bëjmë këtë. Të bashkuar, pa dallim, të lidhur për një qëllim.

Ferizajasit nuk u përkulën kurrë, për asnjë çmim, para askujt. Ishin në ballë gjithnjë. Kurdoherë, gati për sakrificë.

Ferizaj është lavdi, me heroizëm ndër epoka - zë vend sublim në faqe të historisë. Përjetësisht - kujtojmë lavdinë e bashkë ndërtojmë të ardhmen!

Mijëra familje kanë lidhur fatin me këtë qytet. Mijëra foshnje i japin buzëqeshje e jetë. Çdo i ri thur tëardhmen e ndërton veten në këtë qytet.

Siç kemi lidhur kontratën me qytetarët dhe për këtë kemi dhënë dëshmitë se e mbajmë fjalën, bashkë ia dalim - Do ta bëjmë Ferizajn e Gjeneratës Tjetër, Ferizajn në Tjetër Nivel, Ferizajn me mundësi për të gjithë.

Me dashuri, me krenari, zell e vizion, për Ferizajn tonë.

Nga zemra, me gjithë qenien time, FALEMINDERIT FERIZAJ!

QYTETI IM, KRENARIA IME, DASHURIA IME!

Faleminderit ferizajas që më dhatë nderin e privilegjin t'ju shërbej, me besimin tuaj të pamat!

Faleminderit familjes sime politike, miqve e bashkëpunëtorëve nga të gjitha krahët e forcave politike, për rrugën e drejtë që po bëjmë bashkë!

Faleminderit familjes sime për kurajën e mirëkuptimin në çdo hap!

Për Ferizajn gjithmonë, për ferizajasit pa ndalë!

Na priftë e mbara, bashkë!

Pas fjalimit të Kryetarit Agim Aliu, Kryesuesi i kësaj mbledhje kërkoj 30 minuta pauzë dhe i ftoj që të shkojmë në koktej rasti tek hotel Metropol.

Menjëherë pas rikthimit në seancë në ora 11:30, Kryesuesi i kësaj seance vazhdoi me rendin e ditës e që tash ishte zgjedhja e Kryesuesit të ri të Kuvendit dhe pyeti nëse ka propozime.

Arian Imeri propozoi Xhavit Zariqin për kryesues të Kuvendit në emër të koalicionit dhe si emër që ka qenë i dëshmuar para gjatë dhe pas luftës, po ashtu i njëjti ishte edhe kryesues i kuvendit në legjislaturën e kaluar.

Kryesuesi i kësaj mbledhje pyeti nëse ka propozime tjera dhe pasi nuk pati vazhdoi me procedurë, për themelimin e komisionit për verifikimin e mandanteve dhe ftoj që partit në kuvend të propozojnë anëtarët:

Nga PDK Arian Imeri për këtë komision propozoi Maliq Muharremin,

Nga LVV Brahim Osmani propozoi Hysen Hyseni,

Nga LDK Jehona Mustafa propozoi Besnik Salihun,

Nga AAK Alberton Sahiti propozoi Hatixhe Bungu Qerimi

Nga Ne MUNDEMI u propozua Dorentin Azizi pasi u lexuan emrat u votuan në tërësi me 40 vota për, 0 kundër, 0 abstenim .

Më pas u votua komisioni për zgjedhjen e kryesuesit në këtë përbërje

PDK- Vanesë Sadriu Topojani

LVV- Yllkë Neziri Hyseni

LDK- Jehona Mustafa

AAK- Alberton Sahiti

Inicativa ne Mundemi - Habib Krosa.

Edhe ky komision u votua me 40 vota për, 0 kundër, 0 abstenim

Më pas u krye votimi, ku për zgjedhjen e Kryesues të Kuvendit Xhavit Zariqi ishin 26 vota për, 7 kundër dhe 0 abstenim.

Procesmbajtësi



Leutrim Mahmuti

Anëtar i më i vjetër i KK-së



Xhavit Zariqi